



**UNIVERSITETI I EJK
JNE YHIBEP3ITET
SEE UNIVERSITY**

**FAKULTETI
I ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE SHKENCAVE POLITIKE**

**PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE
(Master of Arts)**

TITULLI I PROGRAMIT:

STUDIME TË DIPLOMACISË

Programi për studime të magjistraturës për diplomaci

1. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi për studime të magjistraturës për diplomaci është dizajnuar që ta zhvillojë kuptimin konceptual të studentëve për praktikat dhe procedurat e diplomacisë moderne dhe t'u ndihmojë që në mënyrë efektive të punojnë në bashkësinë diplomatike. Program është dizajnuar për diplomat, nëpunës të lartë në përfaqësi të ndryshme ministrore jashtë vendit, anëtarë të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe nëpunës të organizatave joqeveritare dhe korporatave multinacionale. Ky program, gjithashtu, u dedikohet atyre të cilët në të ardhmen duan ta zhvillojnë karrierën e tyre diplomatike, ose të punojnë në sektorë tjerë qeveritar ose në kompani multinacionale. Ky program për studime të magjistraturës është kombinim i studimeve akademike dhe trajnimeve profesionale. Sfera e komunikimeve ndërkombëtare dhe kulturore, e drejta ndërkombëtare dhe ekonomia ndërkombëtare plotësohen me disiplinat akademike të cilat studiohen. Aspektet profesionale ligjërohen nga ana e diplomatëve, politikanët dhe nëpunës të lartë qeveritar, të cilët do të ligjërojnë si profesor të jashtëm. Programi përmban 120 kredi dhe do të realizohet përmes studime të rregullta në kohëzgjatje prej 4 semestrave (në secilin semestër nga 30 kredi). Studentët të cilët do ta ndjekin këtë program të studimeve të magjistraturës, do të mund të punojnë në ministrinë e jashtme, sektorin qeveritar dhe në fushën e diplomacisë ndërkombëtare. Të tjerët mund të punojnë në: sektorin e biznesit, sektorin juridik, polici, në bankë, në gazetari, konsultant menaxhimi, në bibliotekari dhe ligjërues.

Qëllimet e programit:

- Ta zhvillojë kuptimin konceptual të studentëve për praktikat dhe procedurat e diplomacisë moderne;
- Ta rritë aftësinë e studentëve për të punuar në mënyrë efektive në kuadër të diplomacisë;
- T'i mësojë studentët të shkruajnë, prezantojnë punime kërkimore dhe të hartojnë projekte kërkimore nga diplomacia;
- T'i përgatit studentët të punojnë në diplomaci, në përfaqësi ose në sektorët e punëve të jashtme nëpër ministri, si dhe si anëtarë në organizatat ekonomike ndërkombëtare dhe në organizatat tjera.

Programi për studime të magjistraturës për diplomaci

<i>Semestri 1</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimër or/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Metodologjia e hulumtimit	6	D	15	30	180	20-30
Institucionet ndërkombëtare	6	D	30	15	180	200/20-30
Historia e diplomacisë	6	D	30	15	180	200/20-30
Globalizmi si fenomen i shoqërisë bashkëkohore	6	D	30	15	180	200
Lënda zgjedhore	6	D	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30		135	90	900	

Lëndët zgjedhore:

1. Gjuhë angleze për qëllime specifike;
2. Shkrimi akademik në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase;
2. Marrëveshjet ndërkombëtare

<i>Semestri 2</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimër or/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Marrëdhëniet ndërkombëtare	6	V	30	15	180	20-30
Unionin European: institucionet, politika dhe e drejta	6	V	30	15	180	200/20-30
Diplomacia dhe metodat diplomatike	6	V	30	15	180	200/20-30
Etika politike: e vendit, ndërkombëtare dhe diplomatike	6	V	30	15	180	200/20-30
Lënda zgjedhore	6	V	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30	II	150	75	900	

Lëndët zgjedhore:

1. E drejta publike ndërkombëtare;

NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I PROGRAMEVE STUDIMORE

2. Politikat e botës së tretë;
3. Etika dhe kultura në politikën botërore

<i>Semestri 3</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimër or/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Zgjidhja paqësore e kontesteve	6	D	30	15	180	20-30
Sistemet politike krahasuese	6	D	30	15	180	200/20 - 30
Sistemi i Kombeve të Bashkuara	6	D	15	30	180	200/20 - 30
Analiza e politikës së jashtme dhe politika e sigurisë	6	D	30	15	180	200/20 - 30
Lënda zgjedhore	6	D	15	30	180	200/20 - 30
Gjithsej	30		120	105	900	

Lëndët zgjedhore:

1. Gjuhë angleze për qëllime specifike,
2. Politikat e vendeve në zhvillim
3. Protokolli diplomatik

<i>Semestri 4</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dimëror/ Veror</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët praktike</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Punimi i tezës së magjistraturës	30	V	0	225	900	Индив.
Gjithsej	30		0	225	900	

Lëndët zgjedhore:

Gjuhë angleze për qëllime specifike;
 Shkrimi akademik në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase;
 Negociatat ndërkombëtare
 E drejta publike ndërkombëtare;
 Politikat e botës së tretë;
 Politikat e vendeve në zhvillim;
 Protokolli diplomatik;
 Teoria strategjike.

PËRSHKRIMI I LËNDËVE

SEMESTRI 1

Metodologjia e hulumtimit

Kjo lëndë ju ndihmon studentëve t'i kompletojnë detyrat hulumtuese ekstensive dhe detyrat e shkrimit, të cilat janë të nevojshme në programin e magjistraturës, duke e përfshirë edhe shkrimin e tezave sipas standardeve më të larta akademike, relevante për qëllimet e karrierës studentore. Temat përfshijnë teknikat hulumtuese primare (empirike) dhe sekondare, dokumentacionin burimor, bibliografinë, selektimin, interpretimin dhe organizimin e informacioneve, formatimin dhe rregullimin. Një gjë e tillë ju mundëson studentëve një përvojë të mirë në shfrytëzimin e bazës së të dhënave dhe internetin në procesin e studimit. Gjithashtu, studenti mëson se si të punojë në mënyrë efektive me mentorin në përgatitjen e tezës së tij.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Institucionet ndërkombëtare

Ky është një kurs i avancuar për studimin zhvillimit, aktiviteteve dhe ndikimin në organizatat ndërkombëtare. Pas diskutimit për evalvimin e organizatave ndërkombëtare, ky kurs i studion strukturat administrative dhe strukturat e sjelljes së vendimeve, si dhe funksionimin e shumë politikave të rëndësishme ndërkombëtare, institucionet ekonomike dhe ushtarake, si dhe NATO-n, Këshillin e Europës, Organizatën e sigurisë dhe të bashkëpunimit evropian, Organizimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ligën arabe etj. Në këtë kurs analizohet se si struktura organizative e këtyre organizatave ndikon në politikat e vendeve anëtare, si dhe si janë të kushtëzuara vendimet institucionale me politikat e vendeve anëtare. Vëmendje e posaçme do t'ju kushtohet edhe perspektivave të organizatave ndërkombëtare.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Historia e diplomacisë

Ky modul e studion zhvillimin e diplomacisë nga Marrëveshja e Uestfalisë (1648) deri nga fundi i Luftës së dytë botërore dhe i përpunon ngjarjet kryesore diplomatike nga fundi i Luftës së dytë botërore deri në ditën e sotme.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Globalizimi si fenomen e shoqërisë bashkëkohore

Qëllimet e materies studimore

Globalizimi si fenomen do t'ju mundësojë studentëve të njihen dhe t'i identifikojnë ndryshimet kulturoro-civilizuese, të cilat i prezantojnë globalizmi në botë, paradigmat e reja të proceseve botërore të globalizimit dhe të ndërkombëtarizimit të

mileniumit të ri. Përmbajtja mundëson njohjen e mirë të metodave të udhëheqjes me ndryshimet radikale. Në këtë drejtim, do të përpunohen: dimensionet e ndryshimeve radikale, të udhëhequrit me ndryshimet, procesi i globalizimit, strukturat dhe ndryshimet organizative, bashkëpunimi, konkurrenca, perspektivat, konkurrenca kombëtare, konkurrenca ndërkombëtare, perspektivat mikroekonomike, tregtia, efektet e liberalizimit të tregtisë, normat rregullatore të transparencës dhe efekti i tyre.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

SEMESTRI 2

Marrëdhëniet ndërkombëtare

Ky kurs ka dy tema qendrore. E para, është t'i njohë studentët me lëndën e të drejtës ndërkombëtare dhe me marrëdhëniet ndërkombëtare përmes mësimit të koncepteve, teorive, perspektivave dhe çështjeve dhe problemeve qendrore në këtë sferë. Kështu, do të studiohen Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare si disiplina akademike dhe perspektivat ose qasjet, të cilat janë shfrytëzuar ose rrjedhimisht janë shfrytëzuar në analizën e ngjarjeve dhe proceseve ndërkombëtare. Do të studiohen problemet konceptuale dhe teorike në studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare: Cilat janë personat kryesorë në marrëdhëniet ndërkombëtare? A kanë marrëdhëniet ndërkombëtare dimension etik? A është ndërruar koncepti “i sigurisë” gjatë 50 vjetëve? Do të merren parasysh problemet e shumta qenësore në marrëdhëniet ndërkombëtare: zhvillimi ndërkombëtar, të drejtat e njeriut, kriza me borxhet, kriza në Kosovë, kontestet tregtare dhe a do të bëhet përpjekje që ato të lidhen me problemet teorike. Qëllimi nuk është të mësohet gjithçka që duhet të dihet për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare, por të krijohet një ndjenjë për atë se ç'janë në të vërtetë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare, si janë zhvilluar dhe në çfarë kahe shkojnë. Qëllimi i dytë, është që t'ju ndihmojë studentëve t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre, prandaj këtu janë përfshirë edhe ushtrimet dhe detyrat e shtëpisë, të cilat janë dizajnuar me qëllim të përforsimit të shkathtësive të ndryshme që i posedon studenti.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Unionin European: institucionet politika dhe e drejta

Ky modul i studion teoritë dhe praktikën e politikës evropiane dhe integrimin ekonomik, duke e përpunuar procesin integruar prej vitit 1950 deri më 1990, dhe duke u fokusuar në vitin 1992 dhe pas këtij viti. Analizohen ndryshimet institucionale dhe politike në politikë, ekonomi, në marrëdhëniet e jashtme dhe në mbrojtje, duke na çuar deri në Marrëveshjen e Maastrichtit dhe të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, diskutohet edhe unifikimi politik, integrimi socio-ekonomik dhe kulturor, ratifikimi i sistemit ndërkombëtar dhe rruga e bashkëpunimit me Europën Lindore dhe shtete e Mesdheut.

Lënda, gjithashtu, e studion strukturën dhe procesin e sjelljes së vendimeve të Bashkimit Europian përmes analizës së problemeve rrjedhëse, duke e përfshirë edhe politikën agrare, kontrollin buxhetor dhe politikën monetare, çështjet sociale dhe rajonale dhe politikën lidhur me integrimin më të madh të vendeve anëtare. E studion praktikën ndërkombëtare të bërjes së kontratave, pjesëmarrjen e Bashkimit Europian në organizatat tjera ndërkombëtare, ndikimin e ligjit kushtetues dhe ligjin për treg të përbashkët të BE-së në bazë të marrëdhënieve të saj të jashtme dhe statusin e së drejtës ndërkombëtare si pjesë integruese e sistemit juridik të Unionit. Marrëdhëniet reciproke midis tregtisë ndërkombëtare dhe tregtisë së Unionit, marrëdhëniet monetare, konkurrencën, dhe ligjet e mjedisit jetësor, si dhe politikën e ilustruara si „case studies“.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Diplomacia dhe metodat diplomatike

Ky kurs i avancuar i studion: funksionet e diplomacisë, krijimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike, relacionet midis politikave diplomatike dhe të jashtme, shërbimet sekrete diplomatike dhe spiunazhin, parimet, praktikën dhe problemet e imunitetit të diplomatit. E studion organizimin e misioneve diplomatik jashtë, rolin e ambasadorëve dhe nëpunësit tjerë diplomatik, duke e përfshirë edhe përgjegjësinë e tyre ndaj qeverive të veta, si dhe marrëdhëniet e tyre me qeveritë e vendeve në të cilat janë emëruar. Bëhen analiza lidhur me atë se si diplomacia është e lidhur me komunikimin, konfliktin, menaxhimin, negociatat dhe diskutohet diplomacia e specializuar dhe ndikimi i teknologjisë së diplomacisë. Kursi ofron trajnim të specializuar për strukturat dhe mekanizmat e diplomacisë me shfrytëzimin ekstensiv të teknikave simuluese. I zhvillon aftësitë e theksuara për të shkruar dhe folur, etikën profesionale, teknikën negociatave dhe e studion organizimin burokratik. Të aftëson për përgatitjen e raporteve analize dhe faktike dhe të memorandumëve, propozim-politikat dhe korrespondencën formale diplomatike, si dhe për aspektet e marrëdhënieve me opinionin, deklaratat publike për politika dhe konferencat e shtypit.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Etika politike: e vendit, ndërkombëtare dhe diplomatike

Ky kurs ju mundëson studentëve ta studiojnë fushën e etikës me një qasje interdisiplinare. Theksi i është vënë qasjes praktike të dilemave etike, të cilat mund të aplikohen në skenën diplomatike dhe ndërkombëtare. Studenti i studion problemet të cilat kanë të bëjnë me aplikimin e etikës dhe vlerave të sjelljes së vendimeve. Temat përfshijnë teorinë e etikës, dilemat në mbrojtje dhe siguri, etikën në fushatat politike dhe kështu me radhë.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Zgjidhja paqësore e konflikteve

Lënda i studion procedurat gjyqësore dhe jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve midis shteteve. Në të përpunohen roli i negociatave, mediacioni dhe roli i Kombeve të bashkuara në zgjidhjen paqësore të kontesteve ndërkombëtare. Ky kurs e studion edhe sistemin e arbitrazhit ndërshtetëror: ad-hok dhe atë në kuadër të tribunaleve tanimë të formuara si Irani-USA, Klejms tribunali dhe ICSID. Do të studiohen edhe praktikrat dhe procedurat e zgjidhjes së kontesteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në të drejtën tregtare dhe të drejtën e detarisë.

Qëllimet specifike të këtij kursi janë:

1. Të mësohen dhe të kuptohen mekanizmat e ndryshëm ekzistues për zgjidhjen në mënyrë paqësore të kontesteve, të cilat krijohen midis shteteve;
2. Të zhvillohet vetëdija te studentët për përputhjen e mekanizmave të veçantë të zgjidhjes së disa kontesteve;
3. Të studiohen dhe në mënyrë të veçantë të vlerësohen praktikrat dhe procedurat e Gjyqit ndërkombëtar të drejtësisë;
4. Të zhvillohet disiplina te studentët që të angazhohen për zgjidhje paqësore të kontesteve ndërkombëtare.

Sistemet politike të krahasuara

Ky kurs përqendrohet në politikat e reprezentimit, duke u fokusuar në në mënyrë speciale te partitë, zgjedhjet, parlamentin dhe qeveritë. Temat përfshijnë edhe pasqyrën evropiane, Unionin European dhe qeverinë reprezentative, nivelin e udhëheqjes në Europën moderne, politikat e partive dhe sistemi politik, krahasimi i politikës euro-perëndimore me politikën paskomuniste të vendeve të Europës Lindore. Me njohjen e koncepteve kryesore, shkencore të politikës. Kjo lëndë zhvillon edhe të kuptuarit e sistemit politik evropian. Kjo lëndë e përfshinë kornizën konceptuale të politikave krahasimtare dhe i njofton studentët me sistemin qeveritar të disa shteteve evropiane.

Punimi kërkimor është pjesë e detyrueshme e kërkesës akademike të kësaj lënde.

Sistemi i Kombeve të Bashkuara

Kjo lëndë përfshinë origjinën, zhvillimin, strukturën, administratën, funksionin dhe qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë e saj speciale, siç janë UNESKO, UNICEF-i, UNHCR-ja dhe kështu me radhë. Bëhet analiza e punës që ata e kryejnë dhe problemet me të cilat ato merren. Theksi i vihet mënyrës se si vendet anëtare ndikojnë në vendimet dhe politikat e Kombeve të Bashkuara, si dhe mbi mënyrat në të cilat politikrat e jashtme kombëtare kushtëzohen nga ngjarjet diplomatike në Kombet e Bashkuara.

Analiza e politikës së jashtme dhe politika mbrojtëse

Kjo lëndë jep një pasqyrë të disa teorive dhe qasjeve të studimit të politikës së jashtme dhe asaj mbrojtëse. Duke e studiuar politikën e jashtme, kursi përqendrohet në tri sfera: qasja e ndryshme në sjelljen e vendimeve të politikës së jashtme (i studion argumentet se si individët dhe grupet e zhvillojnë politikën e jashtme); qasjen sistimore (studiojnë se si sistemi anarkik ndërkombëtar ndikon në mendimin e individëve, të cilët sjellin vendime dhe çfarë efekti ka kjo në politikën e jashtme) dhe qasja shoqërore (i studion ndikimin e strukturave politike të vendit, grupet e interesit, mendimin publik dhe kulturën kombëtare të politikës së jashtme). Siguron studim sistematik të natyrës së politikës së jashtme dhe si krijohet ajo. Temat të cilat trajtohen janë: definicioni dhe qëllimet e politikës së jashtme; krijimi i politikës së jashtme; procesi i sjelljes së vendimeve në politikën e jashtme; zbatimi; mendimi publik dhe propaganda dhe kështu me radhë. Gjithashtu, ky modul i vë në dukje parimet e nevojave të sigurisë në shtete të ndryshme, mjetet e nevojshme dhe të sigurta për mbrojtjen e tyre dhe procesin e transformimit të këtyre mjeteve në një strategji efektive mbrojtëse. I studion natyrën dhe qëllimet e planifikimit dhe menaxhimit të mbrojtjes dhe në mënyrë të thelluar i studion qasjet e ndryshme, të cilat kushtëzoheshin për një efikasitet optimal. Ky modul përkrahet nga me studime të ndryshme të rastit „case studies“ për strukturat e menaxhimit, furnizimit, buxhetimit, uljen e mjeteve, si dhe për pozicionin mbrojtës.

LËNDËT ZGJDHORE

E drejta publike ndërkombëtare

Qëllimi i këtij kursi është që studentët të fitojnë njohuri për marrëdhëniet ndërkombëtare të subjekteve të së drejtës publike ndërkombëtare, përkatësisht shtetet dhe organizatat ndërkombëtare. Të fitojnë njohuri për kodifikimin e normave dhe rregullave juridike ndërkombëtare, për procedurat e bërjes së kontratave ndërkombëtare dhe zbatimin e tyre juridiko-ndërkombëtar. Studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të shteteve dhe organizatat ndërkombëtare si subjekte themelore në komunikimin ndërkombëtar. Studiohet përkufizimi i nocionit të së drejtës ndërkombëtare, ndarja e saj dhe shpërndarja rajonale. Gjithashtu, u kushtohet vëmendje edhe të drejtave të njeriut si subjekt reflektiv në të drejtën ndërkombëtare, dhe u bëhet një vështrim i veçantë të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të pakicave.

Politikat e botës së tretë

Ky kurs i studion institucionet politike të vendeve në zhvillim dhe i analizon problemet e veçanta, të cilat janë të pranishme në këto vende. Preokupim kryesor janë vendet e botës së tretë, si p.sh. të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine. Gjithashtu, ky

modul i trajton marrëdhëniet e këtyre vendeve, duke im përfshirë edhe aplikacionet politike të konfliktit politik të vendit, strategjitë zhvillimore, sigurinë dhe integrimin rajonal dhe marrëdhëniet me shtete e fuqishme kryesore.

Teoria strategjike

Këtu studiohen çështjet më me ndikim dhe më të rëndësishme në teorinë e strategjisë dhe manifestimi i tyre specifik në doktrinat strategjike të fuqive të mëdha kryesore. Bëhet analizë e ndikimit të Luftës së dytë botërore në teorinë e strategjisë, teorinë e preventivës nukleare dhe kufizimin e luftës, teorinë e luftës guerile, lufta revolucionare dhe strategjitë e sigurisë kolektive. Ky modul, gjithashtu, i studion qasjet e ndryshme analitike të problemeve në konfliktet dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe stabilitetin e sistemit. Problemet si tregtimi midis shteteve, preventiva, eskalimi dhe deeskalimi janë objekt kryesor i studimit në këtë kurs.

Negociata ndërkombëtare

Me rritjen e ndërvarësisë së nivelit ndërkombëtar, personat kryesorë zyrtar janë të detyruar të reagojnë bashkë në mënyrë eksplicite dhe implicite. Ky kurs i mbulon qasjet kryesore teorike të problemeve të bashkëpunimit dhe negociatave ndërkombëtare. Theks i veçantë u vihet institucioneve kryesore ndërkombëtare dhe proceseve të negociatave. Problemet diskutohen në mënyrë të përgjithshme dhe në hollësi, përmes disa shembujve në domene të ndryshme: në siguri, marrëdhëniet ekonomike, politikën e jashtme etj. Krahasimi midis sferave do të ndihmojë të theksohen disa përcaktime kyçe të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Protokolli diplomatik

Lënda protokollit diplomatik i përfshinë komponentët teorike dhe praktike. Studentët do të njihen me kategoritë dhe rregullat themelore të protokollit diplomatik. Qëllimi është studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi, të cilat janë të domosdoshme në aspektin profesional dhe social të diplomacisë, në sferën e gjerë të politikës dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Etika dhe kultura në politikën botërore

Lënda i analizon ndërlidhshmëritë midis etikës dhe kulturës në politikën bashkëkohore botërore. Më parë analizohet se si prezantohet etika dhe kultura dhe çfarë ndikimi kanë ndaj shteteve edhe personat tjerë kryesorë në politikën botërore. Vëmendje e posaçme u kushtohet bashkësive morale dhe tensioneve midis koncepteve universale dhe plurale për të "mirën".

Segmenti i dytë i lëndës ndërlidhet me konceptin e drejtësisë dhe zhvillimin e bashkësive pas konfliktit.

Segmenti i tretë i lëndës i bën një vështrim legjitimitetit, prezantimit dhe konceptit të vetpërcaktimit.

Gjithashtu, lënda i bën vështrim dialogut midis kulturave si dhe mënyrës së realizimit të këtij dialogu në praktikë.